

Për: Këshillin e FIEK

Dekanin, Prof.dr. Isak Shabani

Nga: Prof.dr. Sabrije Osmanaj, anëtare e Komisionit të ankesave

RAPORT

Bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, Rregulloren për studime të doktoratës (Nr. Prot.1/147, dt.16.04.2026), Konkursin për studime të doktoratës për vitin akademik 2026/2027 (Prot.1/345, dt. 07.05.2026), Rezultatet preliminare të Konkursit të shpallura nga Komisioni i FIEK (315/25, dt. 07.07.2026), si dhe ankesat e kandidatëve, paraqes këto konstatime:

Arsyetimi për kandidaten MSc Alketa Sahiti

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në ankesë, vlerësoj se vendimi për mosrangimin e kandidates është bazuar në mosplotësimin e kriterit K3, në përputhje me kushtet e Konkursit, konkretisht pikën III.9 – Dokumentet e nevojshme për aplikim, si dhe me dispozitat e Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës.

Në rezultatet preliminare është sqaruar se kriteri K3 nënkupton dorëzimin e një letre zotimi ose konfirmimi nga një mentor potencial, i cili i plotëson kushtet për mentorim sipas Rregullores.

Lidhur me pretendimin se gjatë periudhës së aplikimit nuk është publikuar lista e mentorëve, vlerësoj se ky pretendim nuk përbën bazë për ndryshimin e vendimit. Rregullorja përcakton kushtet që duhet t'i plotësojë mentori, ndërsa Konkursi kërkon që letra e zotimit të jetë lëshuar nga një mentor potencial që i plotëson këto kushte.

Po ashtu, fakti që emërimi formal i mentorit dhe miratimi i temës së doktoratës bëhen në një fazë të mëvonshme të studimeve nuk e përjashton detyrimin e kandidatit që, në fazën e aplikimit, të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar sipas kushteve të konkursit.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit nuk është konstatuar asnjë fakt apo provë e re që do të ndikonte në ndryshimin e vendimit preliminar. Për rrjedhojë, **ankesa konsiderohet e pabazuar.**

Arsyetimi për kandidaten MSc. Eliona Aliju Ballazhi

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga kandidatja MSc. Eliona Aliju Ballazhi, dokumentacionit të aplikimit, Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, si dhe rezultateve preliminare, vlerësoj se ankesa është e pabazuar.

Sipas pikës 7.1 të kushteve të përgjithshme të Konkursit, kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës, ndërsa fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike dhe publikohen në Konkurs. Në zbatim të kësaj dispozite, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), në kushtet e veçanta të Konkursit (pika II.1), ka përcaktuar se të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se kandidatja ka përfunduar studimet master në programin Master i Shkencave në Energji Elektrike dhe Tregjet e Energjisë, i cili nuk përmbush kushtin e veçantë të Konkursit për pranim në programin e doktoratës të FIEK-ut. Për rrjedhojë, nuk është plotësuar kriteri K1.

Lidhur me pretendimin se programi i përfunduar duhet të konsiderohet si "fushë e afërt", vlerësoj se ky pretendim nuk mund të pranohet. Rregullorja ia njeh njësisë akademike kompetencën për të përcaktuar fushat e afërta dhe kushtet e veçanta të pranimit, ndërsa këto kushte janë përcaktuar dhe publikuar në Konkurs para fillimit të procedurës së aplikimit. Si rrjedhojë, ato janë të detyrueshme dhe zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët. Komisioni për shqyrtimin e ankesave nuk ka kompetencë të ndryshojë ose të zgjerojë kushtet e Konkursit pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Po ashtu, pretendimet lidhur me kohën e marrjes së vendimit nga Këshilli i Studimeve të Doktoratës, identifikimin e kandidatëve përmes numrit të aplikimit, si dhe licencën profesionale dhe përvojën e punës, nuk ndikojnë në përmbushjen e kushteve akademike të konkursit dhe nuk paraqesin bazë për ndryshimin e rezultatit preliminar.

Për rrjedhojë, konsideroj se rezultati preliminar është nxjerrë në përputhje me Konkursin dhe Rregulloren e Përgjithshme për Studimet e Doktoratës.

Prandaj, ankesa e kandidates MSc. Eliona Aliju Ballazhi **konsiderohet si e pabazuar.**

Arsyetimi për kandidatin Ilir Osmanaj:

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga kandidati Ilir Osmanaj, dokumentacionit të aplikimit, Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, si dhe rezultateve preliminare, vlerësoj se ankesa është e pabazuar.

Lidhur me kriterin K1, kandidati pretendon se studimet master në programin Data Science në Technische Universität Wien duhet të konsiderohen si studime në fushë të njëjtë ose të afërt me programin e doktoratës në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Megjithatë, sipas pikës 7.1 të kushteve të përgjithshme të Konkursit, fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike dhe publikohen në Konkurs. Në zbatim të kësaj dispozite, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), në kushtet e veçanta të Konkursit (pika II.1), ka përcaktuar se të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se programi i studimeve të përfunduara nga kandidati nuk bën pjesë ndër programet e përcaktuara në kushtet e veçanta të Konkursit si programe që plotësojnë kriterin K1. Për rrjedhojë, kriteri K1 nuk është plotësuar. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin akademik të programeve studimore ose të ndryshojë apo zgjerojë kushtet e Konkursit pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Po ashtu, pretendimi se vendimi i Këshillit të Studimeve të Doktoratës është marrë pas mbylljes së konkursit nuk ndikon në vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës, pasi kushtet e veçanta të Konkursit kanë qenë të miratuara dhe të publikuara para hapjes së afatit për aplikim dhe janë zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët (Vendim Senati).

Lidhur me kriterin K3, kandidati pretendon se ka dorëzuar letër zotimi nga një profesor i rregullt i FIEK-ut. Megjithatë, sipas pikës III.9 të Konkursit, letra e zotimit duhet të jetë lëshuar nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim sipas Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se ky kriter nuk është përmbushur në mënyrën e kërkuar nga Konkursi. Për këtë arsye, vetëm dorëzimi i një letre zotimi nuk është i mjaftueshëm për ta konsideruar kriterin K3 të plotësuar.

Lidhur me pretendimin se lista e mentorëve potencialë është hartuar pas mbylljes së konkursit, vlerësoj se ky pretendim nuk ndikon në vlerësimin e kriterit K3. Detyrimi që letra e zotimit të jetë nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim buron drejtpërdrejt nga Konkursi dhe Rregullorja.

Pretendimet procedurale të paraqitura në ankesë nuk provojnë se gjatë procedurës së pranimi janë ndryshuar kushtet e Konkursit ose janë vendosur kritere të reja. Vlerësimi është bërë mbi bazën e kushteve të publikuara në Konkurs dhe dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati.

Për rrjedhojë, ankesa e kandidatit Ilir Osmanaj **vlerësohet si e pabazuar.**

Arsyetimi për kandidatin MSc Kastriot Fetahaj

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga kandidati Kastriot Fetahaj, dokumentacionit të aplikimit, Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, si dhe rezultateve preliminare, vlerësoj se ankesa është e pabazuar.

Lidhur me kriterin K1, kandidati pretendon se programi Master në Shkenca Kompjuterike duhet të konsiderohet si program në fushën e njëjtë ose të afërt me programin e doktoratës në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Megjithatë, sipas pikës 7.1 të kushteve të përgjithshme të Konkursit, fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike dhe publikohen në Konkurs. Në zbatim të kësaj dispozite, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), në kushtet e veçanta të Konkursit (pika II.1), ka përcaktuar se të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se programi i studimeve master i përfunduar nga kandidati nuk bën pjesë ndër programet e përcaktuara në kushtet e veçanta të Konkursit si programe që plotësojnë kriterin K1. Për rrjedhojë, kriteri K1 nuk është plotësuar. Komisioni për shqyrtimin e ankesave nuk ka kompetencë të interpretojë në mënyrë të zgjeruar kushtet e Konkursit, të bëjë ekuivalentimin akademik të programeve studimore ose të zgjerojë fushëveprimin e programeve të përcaktuara në Konkurs. Fakti që kandidati ka përfunduar studimet Bachelor në FIEK, apo që programi master është i akredituar dhe përmban lëndë të ngjashme me programin e doktoratës, nuk e ndryshon këtë vlerësim, pasi Konkursi kërkon përmbushjen kumulative të kushteve për studimet Bachelor dhe Master.

Lidhur me kriterin K3, kandidati pretendon se ka dorëzuar letër zotimi nga një profesor i rregullt i FIEK-ut. Megjithatë, sipas pikës III.9 të Konkursit, letra e zotimit duhet të jetë lëshuar nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim sipas Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës. Përmbushja e këtij kriteri nuk konsiston vetëm në dorëzimin e letrës së zotimit, por edhe në faktin që profesori i propozuar t'i plotësojë kushtet për mentorim të përcaktuara në Rregullore. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se ky kriter nuk është përmbushur në mënyrën e kërkuar nga Konkursi.

Lidhur me pretendimin se lista e mentorëve potencialë është hartuar pas mbylljes së konkursit, vlerësoj se ky pretendim nuk ndikon në vlerësimin e kriterit K3. Detyrimi që letra e zotimit të jetë nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim buron drejtpërdrejt nga Konkursi dhe Rregullorja.

Lidhur me pretendimin se kriteret janë ndryshuar pas përfundimit të konkursit, vlerësoj se ky pretendim nuk është i bazuar. Nga dokumentacioni administrativ nuk rezulton se gjatë procedurës së pranimit janë ndryshuar kushtet e Konkursit ose janë vendosur kritere të reja. Vlerësimi është bërë mbi bazën e kushteve të publikuara në Konkurs dhe dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, duke u zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët.

Për rrjedhojë, ankesa e kandidatit Kastriot Fetahaj **vlerësohet si e pabazuar.**

Arsyetimi për kandidaten MSc Arlinda Sheholli Prekadini

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga kandidatja Arlinda Sheholli Prekadini, dokumentacionit të aplikimit, Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, si dhe rezultateve preliminare, vlerësoj se ankesa është e pabazuar.

Nga rezultatet preliminare rezulton se kandidatja nuk është kualifikuar për fazën e mëtejshme të procedurës për shkak të mosplotësimit të kriterit K3, i cili, sipas pikës III.9 të Konkursit, kërkon dorëzimin e një letrë zotimi ose konfirmimi nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim sipas Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës.

Lidhur me pretendimin se dorëzimi i letrës së zotimit nga Prof. Dr. Blerim Rexha është i mjaftueshëm për përmbushjen e kriterit K3, vlerësoj se ky pretendim nuk mund të pranohet. Përmbushja e këtij kriteri nuk konsiston vetëm në dorëzimin formal të letrës së zotimit, por edhe në faktin që mentori i propozuar t'i plotësojë

kushtet për mentorim në përputhje me Rregulloren. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se ky kriter nuk është përmbushur në mënyrën e kërkuar nga Konkursi.

Lidhur me pretendimin se lista e mentorëve potencialë është miratuar pas përfundimit të afatit të aplikimit, vlerësoj se ky pretendim nuk ndikon në ligjshmërinë e procedurës së pranimi. Detyrimi që letra e zotimit të jetë nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim buron drejtpërdrejt nga Konkursi dhe Rregullorja.

Po ashtu, pretendimi se mentori i propozuar ka fituar më vonë të drejtën ose kapacitetin për mentorim nuk mund të merret në konsideratë, pasi përmbushja e kushteve të Konkursit vlerësohet mbi bazën e gjendjes faktike dhe juridike që ekziston në kohën e shqyrtimit të aplikimeve. Ndryshimet që mund të kenë ndodhur pas kësaj faze nuk mund të prodhojnë efekte prapavepruese në procedurën e pranimi.

Rezultatet akademike, aktiviteti kërkimor dhe përvoja profesionale e kandidates, ndonëse përfaqësojnë vlera të rëndësishme akademike, nuk mund të zëvendësojnë përmbushjen e kritereve formale të përcaktuara në Konkurs.

Për rrjedhojë, ankesa e kandidates Arlinda Sheholli Prekadini **vlerësohet si e pabazuar**.

Arsyetimi për kandidaten MSc Alma Novobërdaliu

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga kandidatja Alma Novobërdaliu, dokumentacionit të aplikimit, Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, si dhe rezultateve preliminare, vlerësoj se ankesa është e pabazuar.

Kandidatja pretendon se kriteri K1 nuk përbën kusht eliminues, se programi i studimeve të saj duhet të konsiderohet si fushë e njëjtë ose e afërt me programin e doktoratës, se fushat e afërta nuk janë publikuar dhe se është privuar nga e drejta për t'iu nënshtruar fazës së intervistimit.

Vlerësoj se këto pretendime nuk janë të bazuara. Sipas pikës 7.1 të kushteve të përgjithshme të Konkursit, kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës, ndërsa fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike dhe publikohen në Konkurs. Në zbatim të kësaj dispozite, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), në kushtet e veçanta të Konkursit (pika II.1), ka përcaktuar se të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se programi i studimeve të përfunduara nga kandidatja nuk bën pjesë ndër programet e përcaktuara në kushtet e veçanta të Konkursit si programe që plotësojnë kriterin K1. Për rrjedhojë, kriteri K1 nuk është plotësuar.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave nuk ka kompetencë të interpretojë në mënyrë të zgjeruar kushtet e Konkursit, të bëjë ekuivalentimin akademik të programeve studimore ose të përcaktojë fusha të tjera si fusha të

afërta pas përfundimit të afatit të aplikimit. Për këtë arsye, pretendimet lidhur me përmbajtjen e programit të studimeve nuk paraqesin bazë juridike për ndryshimin e rezultatit preliminar.

Po ashtu, faza e intervistimit zhvillohet vetëm për kandidatët që paraprakisht kanë përmbushur kushtet e përcaktuara në Konkurs. Për rrjedhojë, mosplotësimi i kriterit K1 e përjashton kandidaten nga fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit.

Lidhur me pretendimet për mungesë arsyetimi në rezultatet preliminare dhe për ekzistimin e vendeve të paplotësuara, vlerësoj se ato nuk ndikojnë në ligjshmërinë e procedurës së pranimit. Rezultatet preliminare kanë karakter informues, ndërsa numri i vendeve të lira nuk mund të justifikojë pranimin e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Konkurs.

Për rrjedhojë, ankesa e kandidates Alma Novobërdaliu **vlerësohet si e pabazuar.**

Arsyetimi për kandidaten MSc Ariana Kadriu

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga kandidatja Ariana Kadriu, dokumentacionit të aplikimit, Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, Rregullores së Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, si dhe rezultateve preliminare, vlerësoj se ankesa është e pabazuar.

Lidhur me kriterin K1, kandidatja pretendon se studimet Bachelor në Informatikë Inxhinierike, së bashku me studimet Master në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, përmbushin kushtet e Konkursit. Megjithatë, sipas pikës 7.1 të kushteve të përgjithshme të Konkursit, fushat e afërta përcaktohen nga njësi akademike dhe publikohen në Konkurs. Në zbatim të kësaj dispozite, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), në kushtet e veçanta të Konkursit (pika II.1), ka përcaktuar se të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se programi i studimeve Bachelor i përfunduar nga kandidatja nuk bën pjesë ndër programet e përcaktuara në kushtet e veçanta të Konkursit si programe që plotësojnë kriterin K1. Për rrjedhojë, kriteri K1 nuk është plotësuar. Komisioni për shqyrtimin e ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin akademik të programeve studimore ose të zgjerojë kushtet e Konkursit pas përfundimit të afatit të aplikimit. Për këtë arsye, pretendimet lidhur me përmbajtjen e programit Bachelor nuk paraqesin bazë juridike për ndryshimin e rezultatit preliminar.

Lidhur me kriterin K3, kandidatja kërkon që t'i lejohet zëvendësimi i letrës së zotimit me një mentor tjetër, me arsyetimin se mentori i propozuar kishte arritur numrin maksimal të kandidatëve që mund të mentoronte. Vlerësoj se ky pretendim nuk mund të pranohet. Sipas pikës III.9 të Konkursit, dokumentacioni i kërkuar duhej të dorëzohej brenda afatit të aplikimit. Pas përfundimit të këtij afati nuk ekziston bazë juridike për plotësimin, korrigjimin ose zëvendësimin e dokumentacionit që ndikon në përmbushjen e kushteve të Konkursit, pasi një veprim i tillë do të cenonte parimet e barazisë së kandidatëve, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë në procedurën konkurruese.

Lidhur me pretendimin për listën e mentorëve potencialë, vlerësoj se ky pretendim nuk ndikon në vlerësimin e kriterit K3. Detyrimi që letra e zotimit të jetë nga një mentor potencial që i plotëson kushtet për mentorim buron drejtpërdrejt nga Konkursi dhe Rregullorja.

Po ashtu, fakti që kandidatja është e angazhuar si bashkëpunëtore e jashtme në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike nuk përbën kriter të përcaktuar në Konkurs dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ndikojë në vlerësimin e përmbushjes së kushteve të pranimit.

Për rrjedhojë, ankesa e kandidates Ariana Kadriu **vlerësohet si e pabazuar.**

Prishtine, 15/07/2026

Prof. Dr. Sabrije Osmanaj

